

MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Firdes Shuli, kam votuar kundër shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit Miranda Bushi, pasi kam pasur mendim të ndryshëm në lidhje me penalizimin e subjektit për shkak të të ardhurave nga emigracioni në Itali, shtjelluar në vijim.

1. Paraprakisht sjell në vëmendje periudhat e punësimit dhe emigrimit të subjektit të rivlerësimit Miranda Bushi, si më poshtë:

- dhjetor 1992 – shtator 1998, prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Burrel;
- 1997– 2004, emigracion në Itali¹;
- shkurt 2004 – janar 2008, kancelare e Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda Tiranë;
- janar 2008 – qershor 2012, drejtoreshë kabinetit pranë Prokurorisë së Përgjithshme;
- qershor 2012 – vijim, prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Si subjekt deklarues znj. Miranda Bushi ka kryer deklarimin e interesave privatë periodikë vjetorë që në vitin 2008 e në vijim.

2. Sikurse pasqyrohet edhe në vendimin nr. “***”, datë 25.5.2023, Komisioni ka kryer analizën financiare për periudhën 1992 – 2016 dhe, në përfundim të hetimit administrativ, është konstatuar se: *“Nga analiza e deklaratave të interesave pasurorë privatë/vjetorë dhe asaj Vetting, për periudhën e hetimit 1992 – 2016 të kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme në shumën -37,060,845 lekë për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë, nga ku gjatë ushtrimit të detyrës si prokurore (1992 – 1998 dhe 2012 – 2016 ka rezultuar me balancë negative prej -3,126,598 lekësh”,* balancë e cila është si pasojë e moskonsiderimit të të ardhurave nga emigracioni për periudhën 1997 – 2004, pasi ato nuk plotësojnë kriterin e të ardhurave të ligjshme, në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 86/2014.

3. Në mënyrë të përmbledhur Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit në lidhje me: (i) mosdeklarimin në deklaratën *Vetting* të shumës konkrete të të ardhurave në emigracion; (ii) disa pasaktësi e mospërputhje në deklarime; (iii) të ardhurat nga biznesi i vogël “bar-restorant” për periudhën 2002 – fund 2004, në shumën 2,400,000 lekë dhe mardhenien kontraktuale me shtetasin H.B., përcaktuar shprehimisht në paragrafin 10.15 të vendimit; (iv) balancën negative prej 37,060,845 lekësh nga të cilat -3,126,598 lekë janë gjatë ushtrimit të detyrës së prokurores në periudhën 1992 – 1998 dhe 2012 – 2016.

4. Siç vërehet në arsyetimin e vendimit, në vlerësimin përfundimtar të çështjes shumica ka vlerësuar:

- se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në kundërshtim me shkronjën “a”, pika 5, neni 33 i ligjit nr. 84/2016, për shkak të mosdeklarimit të shumës së të ardhurave nga emigracioni për periudhën 1997 – 2004 në deklaratën *Vetting*;
- të mos konsiderojë të ardhura të ligjshme të ardhurat nga emigracioni, duke iu referuar pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për këtë arsye, pas rishikimit të analizës financiare, bazuar në disa nga pretendimet e subjektit që janë marrë në konsideratë, në përfundim të procesit balanca negative ka zbritur nga 3,126,598 lekë në 28,209,341 lekë për periudhën 1992

¹ Subjekti ka qëndruar në periudhën 1998 – 2003, ndërsa bashkëshorti O.H., në periudhën 1997 – 2004.

– 2016, prej të cilave shuma 452,853 lekë rezulton gjatë periudhës pas rifillimit të detyrës prej subjektit, përkatësisht nga 2012 deri në 2016.

- të marrë në konsideratë argumentet e subjektit në lidhje me pasaktësitë dhe mospërputhjet në deklarime, duke mos i konsideruar ato si shkak për penalizim të subjektit;

- të përfshijë në analizën financiare shumën 1,400,000 lekë, të përfituar nga vëllai i subjektit O.H., për periudhën 2005 – 2007 si të ardhura të ligjshme, si dhe të përfshijë në analizën financiare edhe shumën 1,200,000 lekë/vit, deklaruar nga subjekti si e ardhur e përfituar nga lënia në përdorim e lokalit shtetasit H.B., në DIPP-të 2008 – 2012, që në total përbëjnë shumën 6,000,000 lekë. Sa i takon konstatimeve në lidhje me të ardhurat nga dhënia në përdorim e lokalit shtetasit H.B., dhe marrëdhënien juridike me këtë shtetas, Komisioni nuk ka gjetur problematika që penalizojnë subjektin e rivlerësimit.

5. Pa analizuar në mënyrë specifike çdo barrë prove të kaluar subjektit, unë, si anëtare në pakicë, kam rënë dakord pjesërisht me konkluzionet e shumicës. Konkretisht:

5.1. Sa i takon mosdeklarimit të shumës konkrete të të ardhurave nga emigracioni në deklaratën *Vetting*, që është konsideruar si deklarim i pasaktë në kundërshtim me shkronjën “a”, pika 5, neni 33 i ligjit nr. 84/2016, nuk jam dakord me këtë vlerësim të shumicës, pasi në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar të ardhura nga emigracioni, duke i bashkëlidhur deklaratës edhe disa sqarime e dokumente në lidhje me këto të ardhura. Është e vërtetë që nuk ka deklaruar një shumë konkrete të tyre, për të cilën në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dhe në prapësime ka sqaruar se është një lapsus. Por, për sa kohë këto të ardhura në vlerën totale prej 190.000 euro janë deklaruar në DIPP-në e vitit 2008, e cila përbën provë shkresore sipas përcaktimeve të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në kushtet kur të ardhurat nga emigracioni janë deklaruar në formë likuiditetesh në deklaratat periodike vjetore apo si burim për krijimin e disa pasurive, vlerësoj se ky mosdeklarim është një pasaktësi, e cila nuk sjell ndonjë pasojë për subjektin e rivlerësimit.

5.2. Sa i takon të ardhurave nga emigracioni, në vlerësimin tim, edhe pse nuk u vërtetua që ato përmbushin kriteret e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ky fakt nuk mund ta penalizojë subjektin e rivlerësimit, arsyetuar si vijon.

6. Gjatë hetimit administrativ, nga Komisioni është kryer analizë e të ardhurave të përfituara nga emigracioni në Itali për periudhën 1997 – 2004 (paragrafi 1.8), referuar në mënyrë të përmbledhur në të dhënat e poshtëshënuara:

- Në DPFD-në e vitit 2008, kur subjekti ka qenë me detyrë drejtore kabineti në Prokurorinë e Përgjithshme dhe është bërë për herë të parë subjekt i deklarimit sipas ligjit 9049/2003, i ndryshuar, në rubrikën “Angazhime dhe veprimtari private” subjekti ka deklaruar: “*Të ardhura nga puna në emigracion gjatë viteve 1998 – 2003 në shumën 40,000 euro; të ardhura nga puna e bashkëshortit në emigracion gjatë viteve 1997 – 2004 në shumën 150,000 euro*”. Në po këtë deklaratë ka deklaruar “*gjendje cash në banesë në shumën 100,000 euro*”, por nuk ka deklaruar sipas shumicës burimin e krijimit të kësaj shume edhe pse në këtë formular kërkohet deklarimi i tij. Nuk jam dakord me këtë konstatim, pasi, përderisa subjekti ka deklaruar të ardhura nga puna në emigracion, është e kuptueshme që burimi i gjendjes *cash* ka qenë me këto të ardhura, për sa kohë është vërtetuar që gjatë këtyre viteve subjekti ka qenë familjarisht në emigracion dhe nuk ka të dhëna për realizim të ardhurash nga burime të tjera.

- Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga emigracioni dhe i ka bashkëlidhur kësaj deklaratë dokumentacionin: (i) leje qëndrimi për të huaj në emër të shtetasit

O.H., për periudhën 11.11.1998 – 6.11.2002, lëshuar nga Ministria e Brendshme Italiane; (ii) kartë identiteti në emër të shtetasit O.H., lëshuar në datën 21.2.2000, me afat 5-vjeçar; (iii) librezë pune në emër të shtetasit O.H., ku identifikohen periudhat e punësimit 17.11.1999 – 5.1.2000, 30.10.2000 – 23.11.2000 dhe 2.11.2001 – 15.12.2001; (iv) certifikatë e rezidencës në emër të shtetasit O.H., lëshuar në datën 19.10.2002, në Parma; (v) listëpagesë për muajin nëntor 1999 me pagë neto 193 euro, listëpagesë për muajin dhjetor 1999 me pagë neto 455 euro, listëpagesë për muajin janar 2000 me pagë neto 105 euro, listëpagesa për muajin nëntor 2001 me pagë neto 946 euro.

- Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, ka dhënë një sqarim lidhur me emigracionin në Itali, ku shpjegon se në korrik 1997 kanë shkuar familjarisht në Itali me vizë të rregullt. Bashkëshorti i saj ka punuar vazhdimisht, por pa dokumente, sepse punëdhënësit e tij në Itali nuk e punësonin me dokumente, përveç dy muajve që duheshin për të marrë *permesso di soggiorno*. Bashkëshorti ka punuar në vende të ndryshme deri në vitin 2004. Subjekti ka sqaruar se ka punuar në Itali në periudhën 1998 – 2003, por nuk disponon dokumentacion. Të ardhurat e fituara kanë shërbyer për blerjen e aseteve të deklaruara, si dhe për përballimin e shpenzimeve familjare ndër vite në Shqipëri.

- Subjekti i rivlerësimit, e pyetur në ILDKPKI, në vitin 2009, pasi i është kërkuar që të vërtetojë me dokumentacion ligjor të ardhurat e realizuara prej saj në emigracion në Itali në shumën 40,000 euro, për periudhën 1998 – 2003 dhe për të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti i saj O.H., në shumën 150,000 euro për periudhën 1997 – 2004, ka deklaruar se: “*Nuk disponon dokumentacion justifikues për të ardhurat e realizuara prej saj dhe bashkëshortit nga emigracioni në Itali*”.

- Me pyetësonin nr. 3 i është kërkuar subjektit që të japë informacionin mbi shpenzimet jetike për vitet e qëndrimit me familjen në Itali për periudhën 1997 – 2004. Në mënyrë të përmblodhur subjekti ka shpjeguar se për shpenzimet jetike të familjes për periudhën 1997 – 2004 në Itali, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nuk mund të japë informacion të saktë, por deklaroi se shpenzimet jetike të kësaj periudhe kanë qenë minimale për shkak të jetesës modeste, si dhe të qëllimit që kishin për të kursyer sa më shumë dhe për t’u kthyer në Shqipëri. Komisioni, për efekt të analizës financiare, ka përllogaritur shpenzimet jetike në Itali, referuar të dhënave të marra nga faqja zyrtare e INSTAT-it italian sipas periudhave të qëndrimit të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit. Subjekti ka provuar me dokumentacion ligjor vetëm shumën prej 1,699 euro si të ardhura të ligjshme nga emigracioni, shumë kjo e përfshirë që në fillim në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

7. Në analizë të prapësimeve të subjektit, pas kalimit të barrës së provës (paragrafi 1.10 i vendimit), nga ana e shumicës është konstatuar se:

- Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se kur kanë shkuar në Itali kanë jetuar me qira dhe gjithmonë shpenzimet për qiranë janë paguar nga vëllai i bashkëshortit, z. L.H., pasi kishte të ardhura të konsoliduara.

- Subjekti ka deklaruar se ka vijuar të punojë në një dyqan buke/pastiçeri, i paregjistruar në organet tatimore. Shpenzimet në Itali kanë qenë minimale, pasi produktet bazë të jetesës siguroheshin falas nga dyqani i bukës. Gjithashtu, edhe vajza K.H., ka frekuentuar kopsht dhe shkollë të financuar nga kisha, e cila mbulonte çdo shpenzim si ushqim, veshje etj. Bashkëshorti O.H., ka punuar në aktivitetin e shitblerjeve të produkteve kozmetike, duke krijuar të ardhura të konsiderueshme dhe, kur ishte i lirë, ka punuar në ndërtim në vende të

ndryshme. Subjekti shpjegon se gjatë kësaj kohe është munduar të kontaktojë me persona, me të cilët ajo dhe bashkëshorti i saj kanë punuar në Itali, por për efekt të kohës së gjatë që ka kaluar (rreth 20 vjet), ka qenë e pamundur për të kontaktuar me ta, përveçse me z. G.C., administrator i shoqërisë “*****” srl, ku bashkëshorti ka punuar në periudha të ndryshme kohore. Subjekti ka depozituar edhe një deklaratë të z. C., për vërtetimin e këtij fakti.

- Subjekti ka shpjeguar se për shkak të jetës modeste dhe me shpenzime të reduktuara, gjendja ekonomike u përmirësua ndjeshëm, dhe në fillim të vitit 2001 vendosi që me të ardhurat e krijuara të blinin lokalit “*****” në B. dhe, më pas, pasuritë e tjera.

- Subjekti ka depozituar të njëjtin dokumentacion (mbi punësimin në shtetin italian) të depozituar më parë, nga ku rezulton se me to provohen të realizuara vetëm të ardhurat në shumën 1,699 euro ose 221,344 lekë.

- Subjekti ka shpjeguar se pjesa më e madhe e të ardhurave të fituara janë dërguar në Shqipëri me transfertë bankare ose *cash* gjatë viteve kur ajo dhe bashkëshorti i saj vinin në Shqipëri dhe janë ruajtur nga babai i saj N.B. Në kërkim të dokumentacionit, subjekti ka mundur të sigurojë dy mandatderdhje në lireta të babait N.B., pranë Bankës Italo-Shqiptare (në vijim BIA), aktualisht Intesa Sanpaolo Bank (ISP në vijim). I është kërkuar informacion kësaj banke për vërtetësinë e tyre dhe banka konfirmon se shtetasi N.B., ka disponuar dy llogari në lireta tek BIA. Gjithashtu, me një përgjigje tjetër kjo bankë konfirmon se shtetasi O.H., ka pasur llogari në lireta në ish-BIA, nr. “****”, por nuk ka detaje të tjera. Nga dokumentacioni i siguruar rezulton se vetëm në 9 muajt e parë në emigracion subjekti me bashkëshortin kanë mundur të kursejnë shumën 27,750,000 lireta që, bazuar në kursin e këmbimit të kohës, përllogariten rreth 15,000 euro kursime, fakt që vërteton trendin dhe shpeshtësinë e të ardhurave të realizuara gjatë periudhës në emigracion, i cili në vitet në vazhdim ka qenë më i lartë. Edhe sikur ky trend të merret i mirëqenë, rezulton se kursimet në emigracion nga bashkëshorti përkohë me shumën e deklaruar të të ardhurave nga subjekti përpara detyrës në vitin 2008.

- Sipas subjektit, për të ardhurat nga emigracioni Komisioni duhet të marrë në konsideratë disa rrethana bazuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Këto të ardhura janë realizuar shumë kohë përpara miratimit dhe hyrjes në fuqi të paketës së reformës në drejtësi, duke përfshirë edhe ligjin nr. 84/2016, për më tepër këto të ardhura janë krijuar edhe shumë kohë para fillimit të detyrës.

- Subjekti pretendon se gjatë gjithë periudhës së deklarimit ka shpjeguar realizimin e të ardhurave në emigracion, duke pranuar faktin se këto të ardhura nuk i justifikon me dokumentacion të plotë ligjor, pasi janë krijuar nga marrëdhënie pune të paformalizuara. Sipas saj, nën dritën e fakteve të parashtruara dhe bazuar në analizën dhe arsyetimin logjik, pasqyrimin ndër vite të vlerave monetare të konsiderueshme në disponim të familjes, si dhe në konsideratë të faktit se deklarimet e saj janë konsistente dhe në to nuk gjenden pasaktësi, arrihet në përfundimin se pasuritë e deklaruar përpara fillimit të detyrës janë krijuar kryesisht me të ardhura të ligjshme të përfituara në emigracion. Po kështu, sipas subjektit, gjatë hetimit janë paraqitur prova dhe deklarime të mjaftueshme, nga të cilat vlerëson se ka përmbushur detyrimin kushtetues duke dhënë edhe shpjegime bindëse mbi ligjshmërinë e të ardhurave dhe pasurive, të cilat qartësisht janë krijuar përpara fillimit të detyrës në vitin 2012. Sa i takon periudhës kur ka ushtruar detyrën e prokurores në vitet 1992 – 1998, përveç kursimit të një vlere të vogël likuiditeti, gjatë kësaj periudhe nuk është krijuar asnjë pasuri tjetër.

8. Është evidentuar se me parashtrimet e veta subjekti i rivlerësimit ka depozituar provat shkresore si vijojnë:

- Deklaratë noteriale nr. “****” rep., nr. *** kol., datë 30.9.2022, ku shtetasi L.H., deklaroi se meqenëse vëllai i tij O. H., i ka dhënë ndihmë në biznesin e tij, nga fillimi i biznesit të tij datë 11.3.2003 deri në shkurt 2004, i ka dhënë nga fitimi i deklaruar një pagë mujore prej 3,000 euro. Shumica arsyeton se *ky dokument nuk u mor në konsideratë nga Komisioni, pasi është dokument deklarativ dhe i pashoqëruar me dokumentacion ligjor që të provojë punësimin e O.H., në këtë biznes, si dhe nuk provon që të jenë paguar tatime/sigurime. Gjithashtu, në lidhje me deklaratën noteriale, Komisioni mban në konsideratë qëndrimet e mbajtura nga Kolegji në çështje të ndryshme sipas të cilave deklarata noteriale, megjithëse nuk është e pavlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia e saj provuese në këtë proces nuk është bindëse, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka të krijojë bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk mbështetet nga dokumentacioni provues për burimin e krijimit të pasurisë në momentin e krijimit të saj.*

- Në lidhje me pretendimin se të ardhurat e realizuara në Itali mbaheshin nga babai i subjektit N.B., një pjesë e të cilave janë depozituar prej tij në ish Bankën Italo-Shqiptare (BIA) në vitin 1998 (në shumën 27,750,000 lireta, e konvertuar në euro në afërsisht 15,000 euro) ka paraqitur mandate të konfirmuara edhe nga Intesa Sanpaolo Bank (ish-BIA). Shumica arsyeton se *Komisioni nuk i mori ato në konsideratë, pasi këto mandate nuk provojnë që këto shuma në monedhën “lireta” të jenë nga të ardhurat e realizuara nga subjekti i rivlerësimit apo edhe bashkëshorti i saj.*

- Deklaratë noteriale nr. “****” rep., nr. “****” kol., datë 15.5.2023, ku babai i subjektit N.B., deklaroi se depozitat në ish-BIA në vitin 1998 janë krijuar nga të ardhurat e realizuara nga puna në emigracionin e vajzës M.B., dhe bashkëshortit të saj. Shumica arsyeton se *Komisioni nuk e mori në konsideratë me të njëjtin arsytim si më lart të dhënë edhe për deklaratën noteriale të shtetasit L. H.*

- Deklaratë e datës 10.5.2023 e shtetasit italian C.G., i cili ka deklaruar se z. O.H., ka punuar në shoqërinë “*****” srl, Milano, me detyrën e konsulentit në periudhën 1.8.1997 – 15.11.1999, me pagesë 2,500,000 lireta neto tatim në burim dhe nga në periudhën 15.1.2000 – 30.10.2000, me pagesën 2,700,000 lireta neto tatim në burim. Shumica arsyeton se *Komisioni nuk e mori në konsideratë, pasi ajo ka karakter deklarativ, është bërë gjatë procesit të hetimit administrativ e konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe nuk mbështetet në dokumentacioni provues të realizimit të këtyre të ardhurave ku të jenë paguar edhe detyrimet tatimore.*

- Një komunikim me postë elektronike të datës 30.9.2022 të bashkëshortit O.H., i cili i drejtohet një shtetasi italian R.L., ku i kërkon informacion për periudhën 1997 – 2004, për sa i përket aktivitetit të punës së tij dhe *email-it* datë 1.5.2023, ku z. O.H., i drejtohet përsëri shtetasit R.L., por nga ky i fundit nuk ka asnjë përgjigje.

9. Në analizë të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, në vlerësimin përfundimtar në lidhje me të ardhurat e realizuara nga emigracioni në Itali në vitet 1997 – 2004, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka arritur të kundërshtojë barrën e provës dhe se subjekti ka provuar me dokumentacion ligjor vetëm shumën 1,699 euro si të ardhura të ligjshme nga emigracioni, shumë kjo e përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, nuk provohet edhe mënyra se si këto të

ardhura janë sjellë në Shqipëri nga subjekti dhe bashkëshorti i saj. Në përfundim të procesit, subjekti është penalizuar për balancën negative prej -28,238,490 lekë.

10. Për të arritur në këtë përfundim, shumica i është referuar: (i) deklarimeve të subjektit pranë ILDKPKI-së në vitin 2009 sipas të cilave nuk disponon dokumentacion justifikues të realizimit të ardhurave të realizuara prej saj në periudhën 1998 – 2003 në shumën 40,000 euro dhe prej bashkëshortit të saj në periudhën 1997 – 2004 në shumën 150,000 euro; (ii) deklarimeve në deklaratën *Vetting* sipas të cilave subjekti dhe bashkëshorti kanë punuar vazhdimisht pa dokumente; (iii) prapësimeve ku subjekti ka deklaruar se nuk disponon dokumentacion të plotë, pasi të ardhurat janë krijuar nga marrëdhënie të paformalizuara. Nisur nga këto rrethana, shumica vëren se *pretendimi i subjektit që ndodhet në kushtet e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 nuk qëndron, për faktin se kërkesat e nenit 32 janë të lidhura me pamundësinë objektive të subjektit të rivlerësimit për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të këtyre të ardhurave në rastin konkret, ndërkohë që subjekti ka deklaruar qartë se nuk disponon dokumentacion justifikues për këto të ardhura, pasi vetë të dy ata (subjekti me bashkëshortin) kanë punuar të pargjistruar në organet tatimore, për më tepër që ka paraqitur dokumentacion zyrtar mbi të ardhurat për vitet 1999, 2000 dhe 2001.*

11. Në vlerësimin përfundimtar të çështjes shumica, gjithashtu, mban në konsideratë edhe qëndrimin që Kolegji ka mbajtur në çështje të ndryshme për të ardhurat e realizuara në emigracion, për të cilat nuk provohet të jenë paguar tatimet dhe sigurimet shoqërore, pasi ato nuk plotësojnë kriterin e të ardhurave të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 86/2014.

12. Në një analizë të të gjitha fakteve/rrethanave të rezultuara nga hetimi administrativ dhe parashtrimeve/dokumenteve që subjekti ka vënë në dispozicion pas kalimit të barrës së provës, sa i takon periudhës së emigrimit dhe të ardhurave nga emigracioni, në mënyrë të përmbledhur, mua si anëtare në pakicë, më rezultoi se:

12.1. U vërtetua se pasi ka lënë detyrën e prokurores në shtator 1998 subjekti ka emigruar në Itali duke iu bashkuar bashkëshortit, i cili ishte larguar që në vitin 1997, për t'u kthyer në vitin 2004 në një detyrë në administratën publike si kancelare e Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda Tiranë. Subjekti ka sqaruar në mënyrë të detajuar, bazuar edhe në dokumente shkresore, në lidhje me situatën pararendëse drejt stabilizimit së bashku me familjen në Itali në tetor 1998, kur vendosi të japë dorëheqjen nga detyra e prokurores, si dhe ka argumentuar qartë dhe logjikshëm shkaqet që i detyruan të emigronin. Në konsideratë të parashtrimeve të saj, si dhe faktit që nuk ka asnjë të dhënë të dokumentuar zyrtarisht apo informacione publike të çdo lloji që subjekti ka ushtruar veprimtari të kundërligjshme përpara largimit nga detyra si prokurore në vitin 1997, mua më krijohet bindja se subjekti realisht nuk e ka vlerësuar punën e prokurorit si një mundësi për përfitime të kundërligjshme dhe se subjekti është e besueshme në deklarinimin e saj se *largimi nga puna për mua ka qenë një vendimmarrje e vështirë, për arsye se po lija profesionin për të cilin unë dhe familja ime kishim investuar dhe sakrifikuar shumë.*

12.2. Subjekti ka sqaruar qartë gjithë periudhën pasrendëse, duke filluar me momentin e pajisjes me leje qëndrimi të bashkëshortit në nëntor të vitit 1998, duke dhënë deklarinime të detajuara, si dhe dokumente shkresore në lidhje me vendqëndrimet në Itali, punësimet e saj dhe të bashkëshortit, shpenzimet e jetesës, e duke pranuar që disa punëdhënës nuk kanë qenë të regjistruar në organet tatimore. Konkretisht, subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me angazhimet

e bashkëshortit në Itali: (i) në aktivitetin e shitblerjeve të produkteve kozmetike me punëdhënës shtetasin italian G.M., duke sqaruar se pagesa e bashkëshortit nuk ishte fikse, por në përqindje, caktuar mbi të ardhurat e realizuara nga shitja duke vënë në dispozicion kodin fiskal të bashkëshortit dhe kodin në INPS (Istituto Nazionale della Previdenza Sociale) të z. G.M., përkatësisht “****” dhe “****”; (ii) si specialist ndërtimi në shoqërinë “*****”, që e administron z. G.Sh., vëllai i ish-bashkëshortit të motrës së subjektit F.Sh., konkretisht në muajt tetor - dhjetor të vitit 2001; (iii) punësimin me vëllain e tij L.H., me pagë neto 3,000 euro/muaj, i cili në mars të vitit 2003 është regjistruar në organet tatimore Torino, Itali, dhe është pajisur me licencë për të ushtruar aktivitet privat në fushën e kozmetikës (shitblerje kozmetike). Subjekti ka vënë në dispozicion të dhënat për aktivitetin e vëllait të bashkëshortit në Itali si vijon: kodi fiskal “****”; numri Rea (Repertorio Economico Amministrativo) TO-“****”; Partita IVA “****”; kodi në INPS “****”.

12.3. Subjekti ka dhënë sqarime të detajuara në lidhje me blerjen në vitin 2001 (ende në emigracion), të një prej asetëve të shoqërisë piramidale “****”, bar-restorantit “*****” në Burrel, me të ardhurat e kursyera në emigracion dhe ka mirargumentuar kronologjinë e ngjarjeve që u bënë shkak i marrjes së vendimit për t’u kthyer në Shqipëri meqenëse situata filloi të përmirësohej (krahasuar me vitin 1997 – 1998 u larguan) në fund të vitit 2003, ndërkohë që bashkëshorti u kthye dy muaj më vonë. Në analizë të parashtrimeve të subjektit dhe në konsideratë të fakteve të ditura publikisht në lidhje me situatën e familjeve që gjatë periudhës së tranzicionit postkomunist në Shqipëri emigronin për t’u kthyer sërish në vendin e tyre, unë i vlerësoj bindëse deklaratimet e subjektit se: *“... unë dhe bashkëshorti im kishim investuar kaq shumë për arsimimin tonë në Shqipëri. Prandaj dëshira jonë për t’u rikthyer profesioneve tona ishte e madhe. Gjithashtu, edhe blerja e kësaj pasurie në Shqipëri ishte një siguri më e madhe ekonomike për ne”*.

12.4. Sa i takon të ardhurave të siguruara në emigracion, subjekti ka bërë përpjekje maksimale që në respektim të afateve të caktuara nga Komisioni të grumbullojë sa më shumë informacione, duke deklaruar se këto të ardhura u materializuan në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme brenda vitit 2004 (lokali në vitin 2001 dhe pajisjet në lokal, pagesat e apartamentit në Tiranë në vitin 2004). Gjithashtu, subjekti ka paraqitur prova shkresore të përpiluara në kohë reale, të cilat vërtetojnë që një pjesë e të ardhurave i janë dhënë hua disa shtetasve, të cilët ia kanë kthyer asaj dhe bashkëshortit gjatë periudhës që ata kanë qenë në emigracion ose menjëherë pas kthimit nga emigracioni. Konkretisht: (i) dhënien e një huaje në prill 2008 dajës së subjektit, shtetasit P.GJ., në shumën 52,000 USD, shumë e cila është kthyer me transfertë bankare, me burim gjendjen *cash* të deklaruar në DPFN-në e vitit 2008; (ii) dhënien e një huaje prej 70,000 euro z. Sh.K., shumë e cila është kthyer në vitin 2007, vërtetuar me deklaratat noteriale nr. “****” rep., “****” kol., datë 10.12.2006 dhe nr. “****”, datë 17.5.2023; (iii) dhënien e një huaje shtetas Dh.H., në vitin 2005, kthyer në vitin 2008, vërtetuar me deklaratën noteriale nr. “****” rep., nr. “****” kol., datë 12.1.2005 dhe procesverbalet e mbajtura nga ILDKPKI-ja, përkatësisht në datat 9.10.2009 dhe 16.9.2009.

12.5. Referuar periudhës së emigrimit dhe të dhënave të ditura publikisht për shtetasit që emigronin jashtë shtetit në vitet 1990 – 2000, si : ndryshime sociale të karakterizuara nga lëvizje të forta migratore, informaliteti i ekonomisë shqiptare në ato vite, remitancat nga jashtë në nivele të larta, të pashoqëruara me burime legale të pagesës nga punëdhënësit dhe të pataknuara në Shqipëri, koha shumë e largët e krijimit të këtyre të ardhurave, subjekti është i besueshëm në deklarinimin *se pjesa më e madhe e të ardhurave të fituara në Itali, me të cilat janë*

blerë pasuritë në Shqipëri, janë dërguar në Shqipëri me transferta bankare ose cash kur vizitonin Shqipërinë dhe janë ruajtur nga babai i saj. Duke deklaruar se nuk është bërë i mundur gjenerimi i të dhënave të tjera, për shkak të mangësive të hedhjes së të dhënave në sistemet e trashëguara kompjuterike, subjekti ka depozituar dy mandatderdhje në lireta dhe ka mundur të sigurojë disa marrëdhënie bankare të babait të saj N.B., pranë Bankës Italo-Shqiptare, aktualisht Intesa Sanpaolo Bank.

12.6. Për të ardhurat nga emigracioni, subjekti, me të drejtë pretendon se Komisioni duhet të marrë në konsideratë disa rrethana, bazuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Po kështu, është i vërtetë pretendimi se këto të ardhura janë realizuar edhe shumë kohë para fillimit të detyrës si prokurore dhe shumë kohë para miratimit dhe hyrjes në fuqi të paketës kushtetuese të Reformës në Drejtësi, duke përfshirë edhe ligjin nr. 84/2016, i cili përcaktoi rregulla specifike në drejtim të provueshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave të siguruara nga subjektet e rivlerësimit, për efekt të kontrollit e verifikimit të pasurive të tyre.

13. Bazuar në sa më sipër në përfundim të procesit, unë si anëtare në pakicë, vlerësoj se:

13.1. Nëpërmjet provave direkte dhe indirekte, subjekti ka vërtetuar bindshëm që ajo dhe bashkëshorti i saj kanë punuar për 7 vite në emigracion në shtetin italian (1997 – 2004), ku kanë realizuar të ardhura, me të cilat kanë krijuar pasuri në Shqipëri. Nga ana tjetër, nuk ka asnjë të dhënë nga organet ligjzbatuese apo informacione të tjera të çdolloji që subjekti apo bashkëshorti i saj të jenë marrë me veprimtari të kundërligjshme brenda apo jashtë territorit të Shqipërisë, që do të vinte në dyshim të ardhurat e deklaruara nga emigracioni.

13.2. Të ardhurat nga emigracioni në vlerën 190,000 euro janë deklaruar nga subjekti që në deklarin fillestar të pasurisë në muajin janar 2008, para fillimit të detyrës si drejtoreshë kabinetit në Prokurorinë e Përgjithshme, duke vijuar me deklarinet periodike vjetore apo shpjegimet e drejtuara ILDKPKI-së, ku këto të ardhura janë deklaruar si burime të krijimit të likuiditeteve *cash* dhe pasurive. Për më tepër, u vërtetua që të ardhurat nga emigracioni janë përdorur për krijimin e pasurive, pasi subjekti është larguar nga detyra e prokurores për të shkuar në emigracion dhe përpara se subjekti të rifillonte detyrën e prokurores në vitin 2012 dhe, pas këtij momenti, subjekti nuk rezultoi të ketë krijuar pasuri apo të ketë deklaruar likuiditete me burim nga emigracioni, çka heq dyshimet për deklarin të ardhurash nga emigracioni me qëllim justifikimin e pasurive të krijuara gjatë detyrës si prokurore. Në këtë këndvështrim, në vlerësimin tim nuk ka dyshime për abuzim me burimin të ardhurat nga emigracioni në funksion të deklarin për efekt të ligjit nr. 84/2016, dhe jo vetëm. Ky fakt, sipas meje, përbën edhe diferencën e subjektit Bushi me disa subjekte të tjera rivlerësimi, të cilat janë penalizuar për shkak të mosvërtetimit të të ardhurave të ligjshme nga emigracioni.

13.3. Ligji nr. 84/2016, Aneksi i Kushtetutës dhe paketa e reformës në drejtësi përcaktojnë dispozitat ligjore bazuar në të cilat organet e rivlerësimit duhet të kryejnë kontrollin e subjekteve të rivlerësimit (gjyqtarë, prokurorë, etj.) me qëllim vlerësimin e krijimit të tyre me burime të ligjshme apo evidentimin e pasurive të fshehta të tyre. Në asnjë dispozitë ligjore nuk parashikohen rregulla, përkufizime a nocione në lidhje me vlerësimin e subjekteve që janë shkëputur përkohësisht nga detyra për shkak të emigrimit. Për më tepër, duke qenë se gjatë viteve të emigracionit subjekti nuk ka qenë subjekt deklarues sipas ligjit 9049, i ndryshuar, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2003, kur subjekti ka qenë në emigracion (e, për rrjedhojë, nuk është njohur me detyrimet e tij), nuk ka treguar kujdes dhe as është angazhuar në mbajtjen e të dhënave që dokumentojnë të ardhurat nga puna të saj dhe bashkëshortit. Nga ana tjetër, procesi

i rivlerësimit në vetvete është një proces administrativ, gjatë të cilit subjektet e rivlerësimit kanë të drejta të rregulluara nga Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë (nenet 35 - 40 dhe 45 - 47). Në ushtrim të të drejtave që përcakton neni 47 i Kodit të Procedurave Administrative, në çdo fazë të procedurës, subjektet kanë të drejtën të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet, rrethana apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova. Në këto kushte, e vlerësoj të pabazuar mosmarrjen në konsideratë nga shumica të deklaratave noteriale të paraqitura nga subjekti në parashtrimet e veta, me arsyetimin se fuqia e tyre provuese në këtë proces nuk është bindëse, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit. Po kështu e vlerësoj të padrejtë bindjen e shumicës se këto akte noteriale apo dokumente të tjera të paraqitura nga subjekti janë konceptuar në favor të deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit. Në vlerësimin tim, në kushtet kur subjekti nuk ka qenë subjekt deklarues gjatë periudhës së emigrimit, deklaratat noteriale dhe çdo provë e paraqitur gjatë procesit që ka lidhje me këtë periudhë, nuk mund të anashkalohen duke u konsideruar si të paraqitura vetëm për efekt të procesit të Vettingut, përkundrazi duhet të analizohen me kujdes në raport me të gjitha provat e rrethanat e evidentuara gjatë hetimit administrativ. Po kështu, në vlerësimin tim, Komisioni, me qëllim administrimin e sa më shumë informacioneve dhe krijimin e bindjes sa më afër realitetit në lidhje me të ardhurat nga emigracioni dhe ligjshmërinë e tyre, mund dhe duhet të verifikonte të dhënat e deklaruara nga subjekti në lidhje me punësimin e bashkëshortit të saj në Itali, përshkruar në pikën 12.2 më sipër.

13.4. Neni 32 i ligjit nr. 84/2016, në pikën 2 parashikon: *“Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër”*. Referuar kësaj dispozite ligjore, vlerësoj se subjekti, i cili gjatë viteve të emigracionit nuk ka pasur detyrimin që të deklaronte/vërtetonte të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, i ka vërtetuar Komisionit se është në pamundësi për të marrë sot në rrugë ligjore informacion për pagimin e detyrimeve tatimore për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar. Në këto kushte, Komisioni, referuar po kësaj dispozite ligjore, duhet të vlerësonte që mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme dhe të konsideronte pamundësinë objektive sipas nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

13.5. Është e vërtetë që për efekt të ligjit nr. 84/2016, subjektet duhet të vërtetojnë të ardhura, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Por, nga ana tjetër, vlerësoj se subjekti ka qenë realisht në vështirësi objektive për të vërtetuar pagimin e detyrimeve tatimore nga punëdhënësi të ndryshëm në shtetin italian për periudhën 1997 – 2004. Po kështu, është objektivisht e pamundur që subjekti të vërtetojë shpenzimet e çdolloji në shtetin italian në vitet e emigrimit (apo të vërtetojë pretendimet se në disa periudha kohore nuk ka pasur shpenzime qiraje apo jetese për shkak të ndihmesës nga familjarë të saj), me qëllim kryerjen e një analize financiare të mirëfilltë sikurse ligji nr. 84/2016 e kërkon, në funksion të realizimit të qëllimeve të tij. Në këto kushte, nëse në dispozitat ligjore do të kishte parashikime për vitet kur subjektet kanë qenë në emigracion, rregullimet përkatëse do të ishin në përputhje me kushtet e jetesës dhe punësimit në emigrim e, për rrjedhojë, vlerësoj se subjektet që përkohësisht kanë qenë në emigrim, nuk mund të barazohen me subjekte që kanë qenë objekt i ligjit 9049/2003, pavarësisht se juridikisht mund të jenë subjekte të ligjit nr. 84/2016.

13.6. Bazuar në sa më sipër, në respektim të plotë të parimeve kushtetuese të parashikuara në nenin D/3 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tim si anëtare në

pakicë, subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj dhe të personave të lidhur, sipas parashikimit në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në posedim ose në përdorim. Për shkaqe të arsyetuara më sipër, mungesa e të dhënave të plota e konkrete që vërtetojnë pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga emigracioni disa vite përpara fillimit të detyrës si prokurore, si e vetmja problematikë për subjektin e rivlerësimit për të cilën nuk ka pasur asnjë të dhënë e informacion për veprimtari të kundërligjshme që do të cenonin figurën e saj, si dhe nuk janë konstatuar problematika në drejtim të aftësive profesionale, nuk mund të përbejë shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit. Nga ana tjetër, duhet mbajtur në konsideratë që balanca negative për periudhën në detyrë prej 452,853 lekë, nuk është e atij niveli që në një vlerësim objektiv dhe proporcional tërësor, të penalizojë të subjektit të rivlerësimit.

Për të arritur në këtë vlerësim, kam pasur në konsideratë edhe vendimin e GJEDNJ-së, e cila ka theksuar në çështjen Xhoxhaj dhe Sevdari se shkarkimi nga detyra – veçanërisht i gjyqtarëve ose prokurorëve me status të përjetshëm në detyrë – është një sanksion disiplinor i rëndë, nëse jo sanksioni disiplinor më i rëndë që mund të vendoset ndaj një individi. Vendosja e një mase të tillë, e cila ndikon negativisht në jetën private të një individi, kërkon marrjen në konsideratë të provave të forta që lidhen me etikën, integritetin dhe kompetencën profesionale të individit².

Bazuar sa më sipër, në perfundim, unë si anëtare në pakicë, në gjëndjen në të cilat janë provat dhe në raport me faktet dhe rrethanat e rezultuara gjatë procesit të rivlerësimit arsyetuar më lart, nuk mund të votoja shkarkimin nga detyra të subjekti të rivlerësimit.

**Anëtare në pakicë
Firdes Shuli**

² Shihni çështjen Xhoxhaj § 403 dhe çështjen Sevdari § 86.